



- PËR:** Komitetin për Politikë dhe Financa, Kryesuesin, z. Haxhi Ibishi; Shërbimin për Punë të Kuvendit, znj. Grishë Gashi;
- NGA:** Kryetari i Komunës së Klinës, z. Sokol Bashota;
- SHTOJÇË:** Procesverbali i takimit publik, 01Nr.06-176/2016 i dt.21/12/2015;
- LËNDA:** Shkresë përcjellëse, sipas të cilës KPF-ja duke u bazuar në nenin 25 të Statutit të Komunës, duhet që të bëj shqyrtimin e Procesverbalit lidhur me Takimin Publik, të mbajtur më datën 21/12/2015;

I nderuari kryesues dhe anëtare të Komitetit për Politike dhe Financa, përmes kësaj shkresë ju rikujtojmë se në harmoni me dispozitat e nenit 25 të Statutit të Komunës së Klinës, të dt.31.03.2010, Komiteti për Politike dhe Financa brenda afatit prej 60 ditësh nga mbajtja e takimit publik bënë shqyrtimin e procesverbalit lidhur me takimin publik, e i cili takim është mbajtur më dt.21/12/2015, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës.

Komiteti në seancën e dytë të radhës për vitin 2015, në përputhje me dispozitat e Statutit të Komunës, si dhe dispozitat e Rregullores për Transparencën, duhet të bën shqyrtimin e procesverbalit dhe shqyrton secilin propozim të dhënë nga qytetarët gjatë takimit më publikun, si dhe bënë rekomandimet e nevojshme për në seancën e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

*Me respekt,*

01Nr. 07-341/2016  
Klinë, dt.04/02/2016



KOMUNA E KLINËS  
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS  
KLINË, 21.12.2015

01 Nr.No.Br. 06-116/16  
Data-Date-Datum 18.01.2016

Klinë-Kline

### PROCESVERBAL

#### I TAKIMIT ME PUBLIKUN, MBAJTUR MË 21.12.2015, NË ORËN 14:00, NË SALLËN E KK

Në takim prezantuan: Kryetari i komunës, Sokol Bashota, nënkyretari i Komunës, Enver Berisha, kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, drejtorë të drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit, OSBE, OJQ-të, qytetarë etj.

Takimin e udhëhoqi kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroj mirëseardhje në këtë takim me publikun.

Sokol Bashota: “Është një takim i obligueshëm që Kryetari i Komunës të prezantojë Raportin njëvjeçar të të arriturave të Komunës. Njoftimi ka qenë i publikuar me kohë, në mënyrë që qytetarët të jenë sa më të informuar për ketë takim”, shtoi kryetari Bashota.

Kryetari Bashota në vijim prezantoi

#### RENDIN E DITËS

1. Rrjedhat e qeverisjes në Komunën e Klinës gjatë vitit 2015, të arriturat, vështirësitet, synimet, si dhe investimet kapitale,
2. Të ndryshme.

Kryetari Bashota në vijim prezantoi projektet e realizuara gjatë këtij viti kalendarik:

- Asfaltimi i rrugës në Sferkë,
- Asfaltimi i rrugës në Përqevë,
- Asfaltimi i rrugës Dush të Sferkës,
- Rehabilitimi i disa rrugëve lokale me zhavorr, nëpër disa lokalitete të komunës së Klinës;
- Sanimi i rrugës në Gjurgjevik të Vogël,
- Kanalizimi në Grabanicë – faza e dytë,
- Kanalizimi për ujitjen e tokave në Jagodë,
- Ndërtimi i serrave për bujq,

- Furnizimi me centrifuga të bletarëve,
- Ndërtimi i tribunave të stadiumit të qytetit, ku sipas Kryetarit me rregullimin e këtij stadiumi sot kemi stadiumin ndër më të mirët në Kosovë; furnizimi me serra për bujq,
- Ndërtimi i nyjave sanitare në shkollën e mesme të ulët “Motrat Qiriazi”,
- Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve, me standardet më bashkëkohore,
- Ndriçimi i një pjese të qytetit, bashkëfinancim, ku sot 80 për qind të qytetit të Klinës janë mbuluar nevojat e ndriçimit,
- Kanalizimi në Klinavc.

Kështu investime kapitale me qëllim të ngritjes së mirëqenies dhe cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës së Klinës, për vitin 2015 janë investuar rreth 2 milionë euro.

Sipas Kryetarit Bashota, disa projekte janë në realizim e sipër, si tri objektet e shkollave fillore, objekti i shkollës fillore në Këpuz, Përqevë dhe Jashanicë, Fabrika e ujit të pijshëm është nën menaxhimin e Hidrodrinit. Jemi në marrëveshje me donatorë që ujët të pijshëm ta shtrijmë edhe nëpër disa lokalitete të Komunës së Klinës; ndërtimin e objektit për banim për kategoritë e luftës së UÇK-së, nga mjetet e Komunës janë ndarë 150 mijë euro; rruga e Resnikut, kanalizimi në Grabanicë – faza e parë; Fabrika për përpunimin e mishit në Videjë (bashkëfinancim) etj.

Kryetari i komunës kërkoi nga qytetarët që të mos i mbyllin gropat septike, sepse nbyllja e këtyre gropave po shkakton probleme të mëdha.

Kryetari, po ashtu prezantoi edhe shqetësimin e banorëve të fshatit Zajm të cilët përballen më vërshimet gjatë stinës së dimrit. Në vizitim kryetari sqaroi ecuritë, përkatësisht projektin si preventivë, që Komuna është duke i ndërmarrë në parandalimin e vështrimeve në këtë fshat, me qëllim të evitimit të rrezikut në vazhdim. “Të mërkurën, më 23.12.2015, kemi një takim me përfaqësues të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe do t'i shikojmë mundësitë e parandalimit të kësaj çështje. Ndërhyrja do të jetë emergjente, sepse me ndërtimin e magjistrales Prishtinë - Pejë që do të kalojë andej, kjo çështje do të rregullohet përfundimisht”, sqaroi Kryetari.

Kryetari në vijim admiroi punën dhe angazhimin e drejtoreve të drejtoreve komunale, e sektorët, të cilët kanë kryer punët dhe angazhimet me përgjegjësitetë më të mëdha, po ashtu, sipas Kryetarit, edhe Asambleja Komunale ka kryer obligimet e veta. “Është një vit i suksesshëm i punës së këtij Ekzekutivi”, konstatoi kryetari Bashota.

Kryetari Bashota në vijim të këtij takimi me publikun, para qytetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, prezantoi projektet prioritare për vitin 2016, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Komunës:

- Mirëmbajtja e rrugëve,
- Ndërtimi i kanalit për ujite në Krushevë e Madhe,

- Ndërtimi i kanalit për ujitje në Gremnik,
- Furinizim me aparat gjeodezik,
- Hartat zonale,
- Ndërtimi i sheshit dhe rrugëve të qytetit,
- Rruga e Dobërdolit (i kryer).

Projekte me donatorë:

- Ngritje e kapaciteteve sportive,
- Ndërtimi i objektit të shkollës në Përqevë,
- Ndërtimi i shkollës në Këpuz,
- Ndërtimi i objektit të shkollës në Jashanicë etj.

Kështu që vlera e projekteve të reja arrin shifrën prej 601.818.00 euro.

Nga Qeveria për vitin 2016 parashihen realizimi i këtyre projekteve:

- Rruga Shtupel – Ranoc,
- Rruga Gjurgjevik i Madh,
- Rruga e Kërnicës,
- Shtrati i lumit Klina.

“Vitin e ardhshëm do të kemi një bashkëpunim më të mirë, mendoj që vitin e ardhshëm do ta kemi edhe më të suksesshëm. Vitin që po vjen do të hymë me një potencial edhe më të mirë financiar, duke shpresuar edhe në ndihmën që do ta kemi edhe nga faktorët relevantë ndërkombëtarë, ndihma e të cilëve nuk na ka munguar asnjëherë”, shtoi ndër të tjera kryetari Bashota.

Në vijim kryetari Bashota hapi debatin.

Musë Gashi, zyrtar në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, foli rreth kanalit të ujitjes në fshatin Grabanicë.

Muhamed Foniqi (Zajm), prezantoi shqetësimin e banorëve të fshatit Zajm dhe rrezikun që ju paraqitet këtyre banorëve si pasojë e vërsimeve që mund të bëhen në këtë kohë dimri. Qytetari Foniqi, kërkoi që Komuna të ndërhyjë sa më shpejt në rregullimin e këtij problemi.

Sokol Bashota, sqaroi hapat që Komuna është duke i ndërmarrë në parandalimin e këtij rreziku. Kryetari sqaroi për takimin që Komuna do të ketë me përfaqësuesit er MPH, ku do të shikohen mundësitë e ndërhyrjeve me qëllim të parandalimit të paraqitjes së këtij rreziku që iu kanoset këtyre qytetarëve.

Arif Elezi, pyeti që projekti i kanalizimit është për fshatin Gjurgjevik i Vogël. Qytetari Elezi, po ashtu prezantoi shqetësimin e objektit të shkollës fillore “Ismet Rraci”, i cili kërkoi që të ndërmerret diçka konkrete në mënyrë që të ndërtohet një objekt shkollor, pasi që nxënësit dhe personeli i shkollës punojnë në kushte tepër të vështira. “Shkolla fillore “Ismet Rraci” është shkolla më e madhe në Komunën e Klinës, prandaj ndërtimi i objektit shkollor është domosdoshmëri, pasi që objekti aktual as për së afërmë nuk i plotëson kushtet”, pohoi z. Elezi.

Sokol Bashota, sqaroi çështjen e ngrehur nga z. Elezi. Për të ndërtuar këtë objekt shkollor duhen mbi 3 milionë euro, që për buxhetin tonë komunal është e pakapërthyeshme. Qeveria e Kosovës dhe MASHT kanë kërkesën tonë, e cila kërkesë është e vazhdueshme dhe tash po presim se çfarë do të ndërmerret në këtë drejtim, sqaroi Kryetari.

Tunë Dedaj (Deqi), prezantoi nevojën e asfaltimit të rrugës Stupë-Jagodë-Zajm, që është obligim i Ministrisë së Transporteve. Dedaj, po ashtu kërkoi që të ndihmohet edhe fshati Zajm rreth çështjes së rezikut nga vërshimet. “Të gjithë e dimë nevojën e ndërtimit të objektit shkollor të shkollës fillore “Ismet Rraci” në Klinë. Kushtet në atë shkollë janë tepër të vështira. Kisha propozuar që objekti i kësaj shkolle të ndërtohet te kompleksi i shkollave, pasi që këtu vendi është i papërshtatshëm është hekurudha që rezikon nxënësit etj. Prandaj, ndërtimi i këtij objekti shkollor te kompleksi i shkollave do të ishte më së i nevojshëm”, shtoi Dedaj.

Sokol Bashota, foli rreth projektit të rrugës Stupë-Jagodë-Zajm. Kryetari Bashota, duke folur rreth ndërtimit të shkollës sqaroi që kërkesa e Komunës qëndron në tavolinat e Qeverisë dhe të MASHT-it. Ndërsa sa i përket vendit ku do të kishte qenë mundësia për ndërtimin e objektit të kësaj shkollore, Kryetari ka pohuar se do të shikohet mundësia për këtë, por sqaroi se aty afër është ndërtuar Palestra Sportive ndër më modernet në Kosovë, e cila ka mundësi të licencohet dhe për lojëra ndërkombëtare dhe në këtë rast duhet krijuar mundësi për parking të automjeteve. “Mungesa e hapësirës pamundëson ndërtimin e këtij objekti aty, prandaj ndërtimi i shkollës në vendin ku gjendet sot është i arsyeshëm nga fakti që në këtë vend mbulohet hapësira e gravitimit të fëmijëve të kësaj pjese të qytetit”, sqaroi kryetari Bashota.

Skënder Merturi, kërkoi shpjegim në detaje rreth projektit të sheshit të qytetit, gjegjësisht cila është alternativa që derisa të rregullohet ky shesh, në cilat kahe të shkojnë automjetet, kah do të zhvillohet transporti që vjen prej drejimit të Istogut etj. “Të shkojnë 1.4 milion euro për këtë projekt është e pakuptimtë. Tjetra, vazhdoi Merturi: shumë fshatra kanë gypat e ujësjellësit, mirëpo nuk kanë ujë të pijshëm. A ka shpresë që do të kenë ujë të pijes këta qytetarë? Shkolla “Ismet Rraci”, që është bërë temë e

diskutimeve dhe që paraqet nevojën urgjente për ndërtimin e saj. Për ndërtimin e sheshit paska para, ndërsa për shkollën jo, kjo është diçka e pajustifikueshme. Të fillohet vetë, me potencialin tonë, pastaj do të ndihmohem me siguri. E potencuat Fabrikën e Ujit të Pijshëm, pohoi Merturi, qytetarët e Klinës nuk janë duke e pirë këta ujë, ata vërehen duke blerë ujet, pastaj po ashtu duke bartur nga Peja dhe Istogu. Pastaj, çka është bërë me veturën që ka pasur defekt?" - shtoi z. Merturi.

Lekë Frroku (Dollc), theksoi se Dollci është paralarje e Klinës, ndërkaq në raportin që u prezantua nga ana e Kryetarit me asnjë fjalë nuk u potencua. "Ky fshat asnjëherë nuk ka përfituar asnjë projekt. Kemi ujësjellësin, mirëpo ujet është të papijshëm. Nuk kemi kanalizim. Jemi taksapagues sikur gjithë qytetarët të tjerë të komunës. Në TV u informuam për shpërndarjen e kontejnerëve, mirëpo në fshatin tonë asnjëherë nuk është shpërndarë asnjë kontejnerë", shtoi z. Frroku, i cili në vijim prezantoi çështjen e objektit të shkollës së Dollcit, i cili objekt është shndërruar në hambar. Zoti Frroku kërkoi që kjo shkollë të merret nën menaxhimin e Komunës, përkatësisht DKA-së. Ai, po ashtu prezantoi edhe çështjen e transportit të nxënësve të këtij fshati, po ashtu edhe disa shqetësime të tjera të banorëve të këtij fshati.


Sokol Bashota, sqaroi çështjet e ngritura nga qytetari Frrokaj. "Është hera e dytë që investojmë në kontejnerë, edhe është e pamundshme që me dy projekte ta mbulojmë gjithë territorin e lokaliteteve të komunës sonë në 54 fshatra. "Vitin e ardhshëm do të mbulojmë gjithë territorin e komunës së Klinës. Domethënë që mbeturinat në komunën tonë po zhduken. Për shkollën e Dollcit do të ndërmarrim diçka konkrete bashkë me DKA-në dhe do ta definojmë statusin e saj. Sa i përket investimeve në janar apo në shkurt të vitit 2016 do të kemi një takim me përfaqësuesit të fshatrave dhe do të shikojmë gjendjen nëpër fshatrat tanë", sqaroi kryetari Bashota.

Në vijim të takimit kryetari Bashota theksoi se kemi edhe një projekt tjetër, do t'i rrisim përgjegjësitë e debateve me qytetarët. "Të dëgjohet zëri juaj. Këto para janë djersë juaja. Ju do të jeni ata që do t'i shpërndani. Ju siguroj që në KK shpejt presim të fillojmë me një projekt, ndërtimin e sheshit të qytetit, që do të jetë njëri ndër sheshet më të bukur që do të ketë Kosova. Sheshi do të rregullohet me kubëza, gurë mermeri, tepër kualitativ, i standardeve evropiane. Pastaj, në kuadër të këtij projekti do të ndërtohet edhe një tunel nëntokësor, ku do të vendosen të gjitha kablloët dhe gypat e nevojshëm, si kablloët e rrjetit elektrik, të postës, gypat e ujet të pijshëm, komplekt do të rregullohen. Më nuk do të kemi shate, sepse rregullimi i këtij tuneli nëntokësor do të mundësojë përfshirjen e gjitha këtyre kabllove dhe gypave nën tokë. Pra, sheshi do të jetë i ndërtuar në mënyrën më bashkëkohore që mund të ekzistojë një shesh", sqaroi kryetari Bashota.

Dhe krejt në fund, kryetari Bashota falënderoi pjesëmarrësit për prezantim. Kryetari po ashtu qytetarëve të Klinës, ju uroi Vitin e Ri 2016, duke iu dëshiruar shëndet, mbarësi dhe suksese!

Takimi përfundoi në orën 15:15 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel Gojani



Kryetari i Komunës,  
Sokol Bashota